



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 245

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kryetarit të bashkisë Tropojë z. Rexhë Byberi

Kërkues: Partia Demokratike, Dega Tropojë

Ndaj: Z. Rexhë Byberi, Kryetar i Bashkisë Tropojë

Baza ligjore: Nenet 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike, Dega Tropojë për veprimtaritë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Rexhë Byberi i cili ka kryer emërimet e reja në punë.



Kallëzimi i paraqitur nga kallëzuesi ruhet në sistem elektronik dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Në denoncimin e raportuar më datë 25.03.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2466 ora 12:26, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Kryetari i Bashkisë Tropojë z. Rexhë Byberi, në kundërshti me ligjin, ka vazhduar dhe vazhdon në dhënien e vërejtjeve, largimin nga puna si dhe emërime të reja në punë, vërtetuar kjo me vendimet bashkangjitur me nr. 24 datë 01.03.2021 dhe nr. 37 datë 22.02.202. Theksoj se Kryetari i Bashkisë Tropojë brenda afatit 4 mujor para zgjedhjeve, ka kryer këto veprime, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020”.*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, Dega Tropojë përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Neni 64 i ligjit nr. 139/2015 “Për organet e vetëqeverisjes vendore” përcakton kompetencat e kryetarit të bashkisë përfshirë kompetencën për sigurimin e plotësimit të të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik edhe është përfaqësues i saj në marrëdhëniet me të tretët.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj z. Rexhë Byberi Kryetar i Bashkisë Tropojë ndaj të cilit atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 e 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/ 2020, të Komisionit Rregullator në KQZ

dhe për të cilat parashikohet sanksion administrativ.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimin e raportuar më datë 25.03.2021 , me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2466 ora 12:26, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Kryetari i Bashkisë Tropojë z.Rexhë Byberi, në kundërshtim me ligjin, ka vazhduar dhe vazhdon në dhënien e vërejtjeve, largimin nga puna si dhe emërimet të reja në punë, vërtetuar kjo me vendimet bashkangjitur me nr. 24 datë 01.03.2021 dhe nr. 37 datë 22.02.202. Theksjo se Kryetari i Bashkisë Tropojë brenda afatit 4 mujor para zgjedhjeve, ka kryer këto veprime, në kundërshtim me nenin 3, shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020”.*

Bashkangjitur denoncimit, si provë për emërimin e punonjësve nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tropojë, është paraqitur urdhëri nr. 37 datë 22.02.2021 “Për komandimin në punë”.

III.

Analiza ligjore

Neni 3, paragrafi 2, i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Neni 3, paragrafi 1, nëndarja 1.3, shkronja “d” i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë të Komisionit Rregullator ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

*“**gjatë fushatës zgjedhore**, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.*

Referuar sa më sipër ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria e ndaluar kryhet **gjatë fushatës zgjedhore**, në kuptim të përkufizimeve të shkronjës “d” paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, të vendimit nr. 9/2020.

Nga provat e paraqitura nga kallëzuesi Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Tropojë vendimi për emërimin në punë është i datës 22.02.2021. Referuar pikës 1, të nenit 77, të Kodit Zgjedhor, “*Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve*”.

Për sa më sipër, veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “**gjatë fushatës zgjedhore**” dhe në kundërshtim **me rastet e përligjura**. Në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, shkronja “d” të vendimit nr. 9/2020, konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet **brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore** nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Kryetarit të Bashkisë Tropojë z. Rexhë Byberi, pasi nuk konstatohen shkelje vendimit nr. 9 /2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

